

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT	
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA	
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION	
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	2
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	8747
Data: Datum: Date:	24.08.2026
PRISHTINË/A	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporti
Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, , në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), bazuar ne dispozitat e nenit 7 (paragrafi 2) të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër urban të udhëtarëve me autobus dhe nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë

VENDIM

I. Aprovohet, pjesërisht kërkesa nr.2423 date 18.02.2026 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus NPT“PLISI COMMERC” Qazim Mustafa BI me seli në Ferizaj për marrjen e nisjeve ne relacionin: Viti-Killokot-Pozhoran-(Autostrada Arbën Xhaferi)-Prishtinë me oraret e nisjeve (12:00 – 18:30) ndërsa pjesa tjetër e kërkesës me nisje respektivisht orare (07:00-09:40) refuzohet.

Arsyetim

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus “ALDI TOURS” shpk me seli në

Lipjan, **ka plotësuar** kushtet ligjore për ndarjen e nisjes të lire në relacionin e lartcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike për marrjen e nisjeve në relacionin: Viti-Klllokot-Pozhoran-(Autostrada Arbën Xhaferi)-Prishtinë me oraret e nisjeve (12:00 – 18:30) ndërsa pjesa tjetër e kërkesës me nisje respektivisht orare (07:00-09:40) refuzohet pasi që pengon në nisjet ekzistuese të vërtetuara nga MIT-ja në relacionin: Begracë-Ferizaj dhe Gjilan-Ferizaj pasi që operatori i lartcekur ka të vërtetuara në rendet e udhëtimit i cili atakohet në orarin e njëjtë gjatë kalimit në trasenë e përbashkët që përshkohet linja duke rrezikuar kohen mbrojtëse të operimit ndërmjet nisjeve respektive në relacionin në fjale.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

Dimal Basha

Ministër



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.